

Spitali i ri i Sëmundjeve të Brendshme drejt përfundimit



Kryeministri Edi Rama dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu inspektuan Spitalin e ri të Sëmundjeve të Brendshme në QSUT, me kapacitet 350 shtretër të rinj, i cili do të ngrejë nivelin e shërbimit shëndetësor publik me standarde europiane. Spitali i ri do të ketë edhe një spital ditor me 60 shtretër, për rritjen e eficiencës së shërbimeve. Spitali i ri i Sëmundjeve të Brendshme do të ketë 9 salla leksioni dedikuar studentëve të mjekësisë, ku do të zhvillohen praktikat mjekësore, si dhe edukimi në vazhdim.



INVESTIMET NË SPITALIN E TRAUMËS

Kryeministri Edi Rama dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, kanë inspektuar punimet që po kryhen në Spitalin Universitar të Traumës, për rehabilitimin e Spitalit të Sëmundjeve të Brendshme, përmirësimin e infrastrukturës në Urgjencën e këtij spitali, si dhe investimet në pajisje bio-mjekësore. Ky investim do të garantojë rikonstruksion tërësor të godinës ekzistuese, rinovimin dhe pajisje, me qëllim modernizimin dhe përmirësimin e shërbimeve që do të ofrohen.



HAPET NJËSIA E KIMIOTERAPISË NË BERAT

Në Spitalin Rajonal të Beratit u hap për herë të parë Njësia e Kimioterapisë, për trajtimin e tumoreve afër vendbanimit. Shërbimi i Kimioterapisë në Berat i shtohet gjashtë kabinetëve të kimioterapisë në spitalet rajonale në Durrës, Shkodër, Lezhë, Fier, Vlorë, Elbasan, duke u garantuar qytetarëve ndjekjen e terapisë së trajtimit të sëmundjeve tumorale, afër vendbanimit.

TETORI ROZË/ MESAZH NDËRGJEGJËSUES PËR KANCERIN E GJIRIT

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu, bashkë me kampionen e atletikës Luiza Gega, përmes një mesazhi, i kanë bërë thirrje të gjitha grave dhe vajzave, për të mos neglizhuar kontrollin e gjirit. Në muajin e ndërgjegjësimit për luftën kundër kancerit të gjirit, Ministria Manastirliu i ka bërë thirrje të gjitha grave të nxitojnë të bëjnë mamografinë. Përgjatë gjithë muajit, MSHMS do të ndërmarrë një fushatë ndërgjegjësimi me moton "Vrapo për jetën".

BLLOK I RI OPERATOR NË MATERNITETIN "KOÇO GLIOZHENI"

Përfundon investimi për bllokun e ri operator dhe repartin e obstetrikës në maternitetin "Koço Gliozeni". Qeveria shqiptare ka financuar rreth 1 milion dollarë në fazën e parë të investimit në Maternitetin "Koço Gliozeni" për rikonstruksionin e bllokut operator, shërbimit të obstetrikës (bllokut të lindjes, dhomave të zgjimit, dhomat e lehonave) dhe pajisjen e tyre me aparaturë mjekësore të standardeve më të mira.

